

FAQ PËR FAMILJET MBI TENDERIN ÇERDHE FALAS:

TREGUESI SIPAS TEMATIKAVE I PYETJEVE E PËRGJIGJEVE:

fq. 2 SI DHE KU PARAQITET KËRKESA PËR TË PËRFITUAR KONTRIBUTET RAJONALE

fq. 3 NË CILAT SHËRBIME 0-3 DO TË JETË E MUNDUR TË PËRFITOHET NGA MASA ÇERDHE FALAS

fq. 4 KUSHTET

fq. 5 TOTALI I KONTRIBUTIT RAJONAL

fq. 7 MASA RAJONALE ÇERDHE FALAS, BONUSI INPS DHE KONTRIBUTET KOMUNALE

fq. 8 KËRKESA E REGJISTRIMIT NË ÇERDHEN E KOMUNËS DHE ÇERDHEN PRIVATE

fq. 10 VIJUESHMËRIA DHE REZULTATI I KËRKESËS

fq. 11 PËR TË PRANUARIT ME KONTRIBUT RAJONAL

fq. 12 RASTET E VEÇANTA

KU DHE SI PARAQITET KËRKESA PËR TË PËRFITUAR KONTRIBUTET RAJONALE:

1) Ku mund ta gjeni aplikimin për të bërë kërkesë për kontributet rajonale?

Aplikimi për të bërë kërkesë do të jetë i disponueshëm nga fundi i majit në faqen e Rajonit të Toskanës.

2) Për sa i përket asaj që thuhet në faqen rajonale doja të dija se kush duhet t'i respektojë afatet e 15/4 dhe të 29/4?

Këto afate u përkasin komunave dhe jo familjeve.

3) Kur do të miratohet njoftimi që u drejtohet familjeve?

Njoftimi për familjet do të miratohet rreth muajit prill 2023 dhe në të njëjtin muaj do të jepen informacione të hollësishme mbi të gjitha aspektet përkatëse.

4) Është e mundur të dihet që tani për çfarë kam nevojë që të bëj kërkesën?

Për të përfituar nga kontributet rajonale, familja do të ketë nevojë për:

- një adresë emaili dhe një numër celulari ku të mund të kontaktohet;
- një ISEE të verifikuar korrektësisht në datën e paraqitjes së kërkesës;
- kredenciale SPID ose kartë identiteti elektronike ose librezë shëndetësore;
- regjistrimin në shërbimin e zgjedhur.

5) Është e mjaftueshme paraqitja e DSU-së për ISEE-në për të bërë kërkesën?

Jo, është e nevojshme që DSU-ja të jetë verifikuar korrektësisht brenda afatit që do të shpallet në njoftimin rajonal dhe të mos i jetë nënshtruar, për shembull, shformimeve apo defekteve.

6) Për cilën ISEE të verifikuar korrektësisht do të kem nevojë për të bërë kërkesë?

Është parashikuar përdorimi i ISEE-së së zakonshme me përjashtim të rasteve që vijojnë: ISEE të miturish të vlefshme në rastin e fëmijëve dhe fëmijëve të prindërve të pamartuar dhe që nuk bashkëjetojnë, ISEE e vlefshme kur të jenë verifikuar ndryshime të rëndësishme të ardhurash, domethënë, ndodhi të pafavorshme si humbja e vendit të punës apo ndërprerja e trajtimeve.

7) Lexova njoftimin për çerdhet falas në Toskanë, ku është shkruar që për të përfituar bonusin duhet bërë kërkesë ndërmjet majit dhe qershorit; ku? Në një qendër CAF?

Kërkesa duhet të paraqitet nga fundi i majit në aplikimin rajonal, i disponueshëm në faqen e Rajonit të Toskanës.

NË CILAT SHËRBIME 0-3 DO TË JETË E MUNDUR TË PËRFITOHET NGA MASA ÇERDHE FALAS

8) Do të jetë e mundur që kërkesa të paraqitet për të përfituar masën rajonale në të gjitha çerdhet private?

Mundësia për të bërë kërkesë do të jetë e lidhur me akreditimin e çerdhes private si edhe me aderimin e subjektit titullar të çerdhes private në masën çerdhe falas në bazë të njoftimit të shpallur nga komuna.

9) Çerdhja ime është vetëm e autorizuar dhe jo e akredituar. Mund të bëj kërkesë për kontributet rajonale?

Jo, duhet të bëhet fjalë për një shërbim privat të akredituar.

10) Ka mundësi të përfitohet nga masa rajonale Çerdhe Falas në rast frekuentimi të hapësirave të lojërave dhe shërbimeve edukative në kontekst shtëpiak?

Ka mundësi, ndryshe nga ç'është parashikuar për bonusin çerdhe kombëtare Inps; edhe për këto shërbime, për reduktimin e tarifave dhe pagesave, janë të vlefshme kufizimet dhe formalitetet e parashikuara për çerdhet e fëmijëve. Gjithsesi, mund të jenë subjekt uljesh përjashtimisht për të tilla tipologji shërbimesh edhe kuotat e tarifave/pagesave më të ulëta se 272,73 dhe 227,27 euro në muaj deri në shumën maksimale € 527,27 për çdo pagesë mujore.

11) Kur do të jepet njoftimi për shërbimet për të cilat është e mundur të përfitohet nga kontributet rajonale?

Me shumë gjasa në fillim të majit 2023 pas miratimit të dekretit ekzekutiv nga Rajoni i Toskanës me të cilin do të përcaktohen shërbimet pranë të cilave do të jetë e mundur të paraqitet kërkesa për të përfituar nga kontributet rajonale.

12) I mbulojnë kontributet rajonale edhe kërkesat në lidhje me shërbimet edukative në kontekst shtëpiak?

Po, duhet të bëhet fjalë, gjithsesi, për shërbime të akredituara nga komuna. Për çdo rast më pas shërbimi në fjalë duhet të paraqesë kërkesën e aderimit në këtë masë të komunës kompetente territorialisht, me formalitetet e përcaktuara nga kjo e fundit dhe të përfshihet në listën e miratuar nga Rajoni.

KUSHTET:**13) Kush duhet të zotërojë kushtin e vendbanimit në një komunë të Toskanës?**

Djemtë dhe vajzat. Kushti i vendbanimit të djalit apo vajzës duhet të jetë në zotërim në çastin e paraqitjes së kërkesës nga ana e prindit/kujdestarit.

14) Mund të marrë pjesë edhe kush ka fëmijë në moshën e kërkuar, i pamartuar dhe që nuk bashkëjeton? Apo është thelbësor të paktën një nga dy kushtet për të bërë kërkesë?

Po. Kërkesat e përcaktuara nuk kanë rëndësi për sa i përket tenderit rajonal Çerdhe Falas.

TOTALI I KONTRIBUTIT RAJONAL:**15) Ka mundësi të jepet ndonjë shembull për të kuptuar se sa është totali i uljes rajonale?**Shembulli i parë:

shpenzimet mujore të parashikuara për lehtësimet bruto:

700 euro bonus inps mujor 272,73 euro (me ISEE nën 25.000)

kupon shërbimi në rast njohjeje nga komuna: 400 euro ulje rajonale 27,27 euro

Shembulli i dytë:

shpenzimet mujore të parashikuara për lehtësimet bruto:

700 euro bonus inps mujor 272,73 euro (me ISEE nën 25.000) ulje rajonale 427,27 euro

Shembulli i tretë:

shpenzimet mujore të parashikuara për lehtësimet bruto:

700 euro bonus inps mujor pa kërkesë

ulje rajonale 427,27 euro

Shembulli i katërt:

shpenzimet mujore të parashikuara për lehtësimet bruto: 200 euro

bonus inps mujor 200 euro (me ISEE nën 25.000 e nga 25.000 në 35.000)

ulja rajonale nuk zbatohet

Shembulli i pestë:

shpenzimet mujore të parashikuara për lehtësimet bruto:

600 euro bonus inps mujor 272,73 euro (me ISEE nën 25.000)

kupon shërbimi në rast njohjeje nga komuna: 327,27 euro

ulja rajonale nuk zbatohet

Shembulli i gjashtë: vetëm në rastin e hapësirës së lojërave apo shërbimit edukativ në kontekst shtëpiak (pra, të pavlefshëm për çerdhet)

shpenzimet mujore të parashikuara për lehtësimet bruto:

700 euro bonus inps mujor nuk zbatohet

ulje rajonale 527,27 euro

16) Pagesa ime e parashikuar të bëhet në shtator 2023 në total 900 euro; do të jetë plotësisht e rimbursueshme?

Ndërhyrja rajonale parashikon uljen e tarifave dhe pagesave që e tejkalojnë kuotën e rimbursueshme nga INPS-i deri në e shumta 800 euro; kuota që tejkalon 800 eurot (në rastin tuaj 100 euro), mbetet për t'u shlyer nga ju.

17) Kam ISEE më të lartë se 35.000 euro; a janë parashikuar masa të mëtejshme për kontribut nga Rajoni?

Nuk janë parashikuar aktualisht.

18) Për çerdhen time private paguhet një shumë regjistrimi dhe për vaktet e fëmijëve veçmas nga tarifa mujore; a janë subjekt rimbursimi edhe këto shpenzime?

Burimet rajonale nuk mund të përdoren për mbulimin e kostove shtesë (si për shembull, pararegjistrimi, regjistrimi, ushqimi) nëse nuk janë përfshirë në tarifë/pagesë.

19) Nëse vendos të shtoj gjatë vitit edukativ orarin e frekuentimit të fëmijës në çerdhe dhe nëse kjo do të rezultonte në shtesën e pagesës, a mund ta njohë Rajoni kontributin edhe për këtë shtesë?

Nuk është e mundur.

MASA RAJONALE ÇERDHE FALAS, BONUSI INPS DHE KONTRIBUTET KOMUNALE:

20) Masa rajonale Çerdhe Falas është ndryshe nga bonusi INPS? Në ç'aspekt?

Bonusi Inps është rimbursim (familja paguan dhe pastaj rimburohet), kurse në rastin e masës rajonale bëhet fjalë për një ulje, pra, përjashtohen shprehimisht shpenzime nga arka e familjes; shpenzimet janë të parashikuara për kuotën e tarifës/pagesës mujore të rimbursuar nga INPS-i dhe për kuotën e tarifës/pagesës më të lartë se 800 euro.

21) Bonusi Inps, kontributet rajonale dhe komunale janë të përputhshme? Mund të paraqes një kërkesë?

Po, për masën e kontributit që ju takon referojuni shembujve të përmendur te FAQ numër 15.

22) Nëse Bonusi Inps nuk kërkohet nga familja, a ka mundësi të bëhet gjithsesi kërkesë për të përfituar kontributet rajonale?

Po. Kërkesa për të përfituar nga masa rajonale do të mbulojë vetëm kuotën që nuk mbulohet nga INPS-i (edhe në rastin kur nuk është bërë kërkesë për bonusin Inps, nëse nuk paraqitet kërkesë për atë vetë). SHEMBULL: nëse shpenzoni 300 euro dhe keni një isee më të ulët se 25.000, masa rajonale do të mbulojë vetëm diferencën mes 300 dhe 272,73 (pra 27,27).

23) Ka mundësi të bëhet kërkesë vetëm për Bonusin Inps ose vetëm për Çerdhe Falas rajonale?

Po, por nëse zotëroni kushtet, është e volitshme të bëhet kërkesë për të dyja, në mënyrë që të keni përfitimin më të madh të mundshëm. Për të patur një ide referojuni shembujve të përmendur te FAQ numër 15.

24) Lehtësimet e mundshme të miratuara nga komunat (për shembull, kuponat e shërbimit, kreditet e hyrjeve) a mund të bashkohen me masën rajonale Çerdhe Falas?

Po. Shuma e përcaktuar si përfundim nga Rajoni do të marrë parasysh kostot që kanë familjet, bonusin Inps dhe lehtësimet e mëtejshme të njohura nga komuna. Në thelb të njëjtat shpenzime nuk mund të rimburohen nga më shumë subjekte publike. Shiko FAQ numër 15) për të kuptuar mënyrat e përlogaritjes së kontributeve rajonale.

25) I lexova informacionet në faqe dhe aty thuhet se për të paraqitur kërkesën duhet bërë aplikimi rajonal online... çfarë do të thotë? Nuk paraqitet të faqja e Inps-it? Veç kësaj, doja të kuptoja nëse, pasi të bëhet kërkesa, më garantohet bonusi apo ka kushte të veçanta për ta marrë?

Bonusi inps dhe uljet rajonale janë 2 masa të ndryshme dhe duhen paraqitur 2 kërkesa. Po ju përgjigjemi për sa i përket uljes rajonale.

Kërkesa për të përfituar nga masa Çerdhe Falas duhet të paraqitet vetëm me aplikimin rajonal në mënyrat që do të saktësohen në tenderin drejtuar familjeve i cili do të miratohet në prill/maj. Masa rajonale do të ketë një tavan burimesh dhe për këtë arsye paraqitja e kërkesës me kushtet e përmbushura nuk jep automatikisht të drejtën e përfitimit të bonusit rajonal. Në rast se burimet rajonale nuk do të jenë të mjaftueshme, do të merren masa që të përpilohet një listë me bazë ISEE-në dhe e mbështetur në disa përparësi që do të përcaktohen në tenderin drejtuar familjeve (për shembull, fëmijët me aftësi të kufizuara). Shih për këtë pikë përgjigjen për FAQ numër 34). Kërkesa për bonusin Inps duhet bërë gjithsesi nga prindi/kujdestari në faqen e INPS-it.

KËRKESA E REGJISTRIMIT NË ÇERDHEN E KOMUNËS DHE ÇERDHEN PRIVATE:

26) Kam ndër mend ta regjistroj vajzën në një çerdhe private të akredituar pa bërë kërkesë në shërbimet komunale; është e mundur?

Për regjistrimin në çerdhen private të akredituar ndër ato të miratuara nga Rajoni, duhet të vërtetohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

- vendet e vëna në dispozicion nga shërbimi privat i akredituar të bëjnë pjesë në ofertën publike të integruar të Komunës/Bashkimit të Komunave;
- mungesë oferte komunale: në territorin komunal ku ndodhet shërbimi për fëmijërinë e hershme privat i akredituar të mos ekzistojë një tipologji e ngjashme shërbimi në pronësi të komunës me të njëjtin orar frekuentimi të vetë çerdhes private;
- kërkesë në listën e pritjes: mungesa e pranimit për pamjaftueshmëri vendesh të disponueshme të kërkesës për të përfituar shërbime në pronësi të komunës (të drejtuara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë), pranë Komunës në të cilën ndodhet shërbimi privat i akredituar, e kërkesës me vendosjen e instancës përkatëse në listën e pritjes;
- vazhdimësi frekuentimi: në rast se djali/vajza ka frekuentuar të njëjtin shërbim për fëmijërinë e hershme privat në vitin edukativ 2022/2023;
- bashkimi familjar: në rastin e vëllezërve/motrave që janë regjistruar njëkohësisht për të njëjtin shërbim;
- papërputhshmëri e orareve të punës të prindërve/kujdestarëve që bëjnë kërkesën: kjo papërputhshmëri, e vërtetuar në administratën e komunës nga të dy prindërit ose kujdestarët, duhet të përkojë me orarin e hapjes së shërbimeve komunale pranë Komunës ku paraqitet kërkesa për përfitimin e bonusit nga njoftimi në fjalë; si ilustrim mund të quhet e vlefshme kërkesa e prindërve që i nisin veprimtaritë e punës në 7.30 dhe çerdhja e komunës hapet në 8.30, ose e përfundojnë orarin e punës në 18.00 dhe çerdhja publike mbyllet në 16.00, ndërkohë që çerdhja private e përzgjedhur e lejon përputhjen me jetën profesionale të prindërve;
- shërbime në afërsi: shërbimi për fëmijërinë e hershme privat i akredituar ndodhet në një distancë më të vogël se 1 km nga vendbanimi apo nga vendi i punës i të paktën njërit nga prindërit ose kujdestarët, në mungesë të një shërbimi të ngjashëm për fëmijërinë e hershme në pronësi të komunës brenda të njëjtës distancë; distanca vërtetohet dhe tregohet duke përdorur një nga navigatorët e disponueshëm në rrjet;
- papërputhshmëri: i mituri nuk mund të përfitojë nga shërbimi për fëmijërinë e hershme të komunës apo në pajtueshmëri në bazë të një vendimi të përcaktuar nga autoritetet gjyqësore apo shërbimet sociale kompetente;
- përjashtime të tjera: në rastin e të miturve të raportuar nga shërbimet sociale apo shëndetësore, apo në zotërim të certifikatave të aftësive të kufizuara sipas ligjit n. 104/1992, apo me problematika psikofizike, sensoriale të certifikuara nga ASL-et kompetente, edhe në mungesë të certifikatave të aftësive të kufizuara sipas ligjit n. 104/1992 apo të caktuar, në bazë të vendimeve të autoriteteve gjyqësore, në kujdestari familjare dhe/ose strukturë, në vitin e kujdestarisë para birësimit, apo në periudhën e njëjtë pas birësimit në rastin e birësimeve ndërkombëtare, apo subjekte programesh/projektesh mbrojtjeje, me kusht që familja kujdestare apo birësuese të ketë vendbanim në një komunë të Toskanës.

27) Çfarë do të thotë “vendet e vëna në dispozicion nga shërbimi privat i akredituar që bëjnë pjesë në ofertën publike të integruar të Komunës/Bashkimit të Komunave”?

Bëhet fjalë për shembull për rastet në të cilat komuna ofron pas miratimit të njoftimit komunal vendet e përcaktuara pranë shërbimeve private të akredituara ku do të jetë e mundur të përfitohen kupona të shërbimeve komunale, ose komuna njih lehtësime apo kredite pranimi për shërbime të përcaktuara.

28) Nëse paraqes kërkesë për çerdhen e komunës a do të kem të drejtë të përfitoj gjithsesi nga kontributet rajonale pa u dashur të paraqes kërkesën në aplikimin rajonal?

Procedurat që kanë të bëjnë me regjistrimin në çerdhen e komunës (dhe lehtësimet e tjera të komunës) dhe kohëzgjatja përkatëse nuk kanë lidhje me kërkesën e aderimit në masën rajonale Çerdhe Falas. Kusht i nevojshëm për të përfituar nga kontributet rajonale është paraqitja e kërkesës nëpërmjet aplikimit rajonal.

29) Regjistrimi në çerdhe bëhet automatikisht me paraqitjen e kërkesës për çerdhet falas?

Procedurat që kanë të bëjnë me regjistrimin në çerdhen e komunës apo private dhe kohëzgjatja përkatëse nuk ka lidhje me kërkesën e aderimit në masën rajonale të çerdheve falas. Regjistrimi në çerdhe, gjithsesi, nuk bëhet automatikisht me paraqitjen e kërkesës për çerdhe falas.

30) Do ta regjistroj vajzën në një çerdhe private në një komunë të ndryshme nga vendbanimi im. A përfshihet ky rast në tenderin “çerdhe falas” ?

Po, por do të jetë e nevojshme që çerdhja private e akredituar të tregojë vullnetin për të aderuar në tenderin rajonal Çerdhe Falas. Raportet administrative që vijnë si rrjedhojë do të jenë me komunën në të cilën ndodhet çerdhja. Shih për këtë rast përmbajtjen e FAQ numër 13.

31) Kërkesa e kontributit është e lidhur me një çerdhe të komunës se vendbanimit apo është e mundur të kërkohet edhe në një komunë tjetër?

Kërkesa e kontributit mund të paraqitet në çerdhe që ndodhen në cilëndo komunë të Toskanës, edhe nëse është e ndryshme nga ajo e vendbanimit. Shih për këtë rast përmbajtjen e përgjigjes së FAQ numër 13.

VIJUESHMËRIA DHE REZULTATI I KËRKESËS:

32) Si mund të ndiqet vijueshmëria e kërkesës?

Vijueshmëria e kërkesës mund të verifikohet nëpërmjet aplikimit rajonal dhe në përfundim edhe në adresën e posaçme të faqes rajonale.

33) Paraqitja e kërkesës për përfitimin e kontributeve rajonale përcakton në çdo rast pranimin e saj?

Pas paraqitjes së kërkesës do të nisë një fazë hetimi nga ana e Komunës dhe Rajonit. Në fund të hetimit, do të përpilohet një listë e të pranuarve për të përfituar nga masa, meqenëse tenderi rajonal ka një kufi maksimal burimesh të disponueshme.

34) Nëse burimet rajonale nuk do të jenë të mjaftueshme për t'u garantuar uljet të gjithë kërkuessve, si do të përpilohet lista?

Do t'u jepet përparësi rasteve të mëposhtme:

- me njoftimin e shërbimeve sociale apo shëndetësore;
- që zotërojnë certifikata aftësish të kufizuara sipas ligjit n. 104/1992 apo problematika psikofizike, sensoriale të certifikuara nga ASL-et kompetente, ose edhe në mungesë të certifikatave të aftësive të kufizuara sipas ligjit n. 104/1992;
- të vendosur, në bazë të vendimeve të autoriteteve gjyqësore në kujdestari familjare dhe/ose strukturë në vitin e kujdestarisë para birësimit, ose në një periudhë të njëjtë pas birësimit në rastin e birësimeve ndërkombëtare, apo subjekte programesh/projektsh mbrojtjeje, me kusht që familja kujdestare apo birësuese të ketë vendbanim në një Komunë të Toskanës..

Pasi të jenë përmbushur këto përparësi, do të vazhdohet me identifikimin e përfituesve nëpërmjet listës së posaçme në bazë të vlerës së ISEE-së familjare, sipas një rendi në rritje (nga më e ulëta te më e madhja).

32) Të dhënat identifikuese të djalit tim do të jenë të dukshme në aktet rajonale?

Jo, do të jetë i dukshëm vetëm kodi identifikues i kërkesës, i dukshëm në aplikimin rajonal në çastin e përfundimit të paraqitjes së kërkesës.

PËR TË PRANUARIT ME KONTRIBUT RAJONAL:**33) A ka kushte të veçanta për njohjen e uljes rajonale?**

Kontributi njihet i plotë në rastin e frekuentimit të të miturit të regjistruar në shërbime shtetërore apo private, për të paktën 5 ditë në harkun kohor të një muaji ose në rastin kur i mituri frekuenton një numër më të ulët në harkun kohor të muajit nëse ky fakt ka ndodhur për shkak të një sëmundjeje të vërtetuar me raport mjekësor.

Gjatë gjithë vitit edukativ, muajt e mungesave për sëmundje mund të njihen deri në e shumta dy, edhe jo në vazhdimësi, me kusht që i mituri të qëndrojë i regjistruar në shërbimin edukativ.

Në rastin e mungesave për sëmundje në regjistër do të jetë i nevojshëm të jetë raporti mjekësor ose në rast se nuk është qartësuar data e fillimit dhe fundit të sëmundjes, nevojitet deklaratë specifike e prindit/kujdestarit të fëmijës në fjalë, sipas modelit në shtojcën F, ku të përcaktohet periudha e mungesës, e shoqëruar me kopjen e dokumentit të identitetit të nënshkruesit.

Në rast se normativa, e miratuar pas zbatimit të njoftimit të tanishëm, shpall të panevojshëm raportin mjekësor, prindi/kujdestari duhet të paraqesë vetëm modelin e shtojcës F.

34) Do të kem detyrime të tjera pas pranimit në kontributet rajonale?

Do të jenë parashikuar në njoftimin drejtuar familjeve; mund t'ju themi paraprakisht se duhet të vërtetoni në aplikimin rajonal uljet e marra për pagesat dhe të plotësoni një pyetësor për cilësinë.

RASTET E VEÇANTA:**35) Çfarë e përcakton tërheqjen e regjistrimit nga çerdhja?**

Tërheqja përcaktohet nga humbja e përfitimit të miratuar nga Rajoni i Toskanës.

36) Vajza ime mbush 3 vjeç në janar 2024; nuk mund të përfitoj më nga kontributet rajonale?

Jo, mbështetja u njihet fëmijëve kur mbushin 3 vjeç në rastin e djemve dhe vajzave që vazhdojnë ta frekuentojnë shërbimin e fëmijërisë së hershme deri në fund të vitit edukativ.

37) Kam vendbanim në Bagno a Ripoli, por vajza ime do të frekuentojë një çerdhe në Firenze. Cilës komunë duhet t'i drejtohem për të patur gjithë detyrimet e parashikuara nga njoftimi rajonal?

Komunës ku ndodhet selia e shërbimit, në rastin tuaj komunës së Firences.

38) Kam një vajzë të lindur në dhjetor 2022, për t'u regjistruar në çerdhe duhet të pres muajin maj kur do të jetë i disponueshëm "aplikimi i posaçëm rajonal" apo duhet bërë më parë?

Data e majit është ajo që është parashikuar aktualisht vetëm për paraqitjen e kërkesës për të përfituar nga kontributet rajonale dhe jo për qëllime të tjera (si për shembull, afati i regjistrimit në çerdhe).